



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

#### *Komisioni i Posaçëm për Reformën në Sistemin e Drejtësisë*

Dokument parlamentar

### PROCESVERBAL

Datë 23.01.2015, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të datës 22.12.2014.
2. Informimi i anëtarëve të komisionit për zbatimin e vendimeve të marra në mbledhjen e komisionit të datës 22.12.2014.
3. Projektvendimet për miratimin e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë për miratimin e organizimit dhe funksionimit të sekretariatit teknik, si dhe miratimin e draftkalendarit të punës së komisionit.

#### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Pandeli Majko, Spartak Braho, Ulsi Manja, Vasilika Hysi dhe Armando Subashi.

#### **Të ftuar:**

Nasip Naço – ministër i Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – drejtoreshë në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Sokol Pasho – drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit Strategjik, Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj** – Përsëritje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë. Janë të pranishëm të gjithë kolegët deputetë, si dhe është numri i nevojshëm për të bërë kuorumin për të zhvilluar këtë mbledhje. I pranishëm në këtë mbledhje të komisionit të posaçëm është ministri i Drejtësisë, zoti Nasip Naço, bashkë me ekipin e ministrisë.

Zoti Ministër, faleminderit që jeni prezent!

Në rendin e ditës janë përsëri disa çështje të natyrës organizative, teknike, që besoj se më në fund do të mundësojnë hapjen e rrugës së procesit, për të hyrë më pas në thelbin e tij javët e ardhshme, në zbatim të vendimit të Kuvendit, duke shpresuar që së shpejti në këtë tryezë do të jenë edhe kolegët tanë të opozitës.

Gjithsesi, për të mos humbur kohë, fillojmë me rendin e ditës.

Në fillim është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22.12.2014.

A ka ndonjë nga kolegët diçka në lidhje me procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Pika e dytë e rendit të ditës është informimi i anëtarëve të komisionit për zbatimin e vendimeve të marra në mbledhjen e komisionit të datës 22.12.2014. Dëshiroj t'ju bëj me dije se në zbatim të vendimit nr. 1 të këtij komisioni, jemi drejtuar me një shkresë zyrtare Ministrisë së Drejtësisë për përgatitjen dhe prezantimin pranë këtij komisioni të një dokumenti analitik me të gjithë informacionin e nevojshëm, të detajuar sipas fushave dhe sektorëve të sistemit të drejtësisë. Ky dokument do të shërbejë si bazë kyçe në funksion të kryerjes së një analize të plotë të gjendjes aktuale të sistemit, me qëllim njohjen dhe evidentimin e problematikave dhe nevojave që kemi për përmirësim. Ky do të jetë dokumenti bazë mbi të cilin do të zhvillohet debati edhe me aktorët e tjerë të sistemit.

Në dijeninë time ministria po bën një punë shumë serioze dhe është në fazën përfundimtare të këtij dokumenti. Besoj që shumë shpejt ne do të kemi mundësinë që ky dokument të jetë në komision, në dispozicion të grupit të ekspertëve. Më pas, bashkë me ministrinë, do të organizojmë tryeza pune dhe konsultimi me të gjithë aktorët e fushës.

Në zbatim të vendimeve nr. 2 dhe 3 të këtij komisioni u jemi drejtuar me një shkresë zyrtare institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë dhe sistemit arsimor dhe akademik në

vend, si: Gjykatës së Lartë, KLD-së, Prokurorisë së Përgjithshme, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, Shkollës së Magjistraturës, Universitetit të Tiranës, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe organizatave e misioneve të asistencës ndërkombëtare në vendin tonë: Komisionit të Venecias, misionit EURALIUS, OPDAT-it, USAID-it, OSBE-së, ambasadës britanike dhe fondacionit “Soros”, fondacioni për shoqërinë e hapur në Shqipëri, për të propozuar emrat e ekspertëve që do t’i çmonin si përfaqësuesit e tyre në përbërje të grupit të ekspertëve të nivelit të lartë.

Në përgjigje të ftesës së këtij komisioni ka dërguar zyrtarisht emrat e përfaqësuesve të tyre në grupin e ekspertëve të nivelit të lartë: Gjykata e Lartë. KLD-ja në përgjigjen e saj ka informuar se, me porosi të Kryetarit të KLD-së, të Presidentit të Republikës, për shkak të organizmit të pavarur, kushtetues të KLD-së, është e arsyeshme që anëtarët e KLD-së të marrin pjesë në procesin e konsultimit dhe të seancave dëgjimore me komisionin e posaçëm, referuar pikave 9 dhe 10 të vendimit të Kuvendit.

Prokuroria e Përgjithshme ka sjellë përfaqësuesit e saj. Gjithashtu, kanë sjellë përfaqësuesit e tyre Dhoma Kombëtare e Avokaturës, Shkolla e Magjistraturës, Universiteti i Tiranës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, EURALIUS-i, OPDAT-i, OSBE-ja, USAID-i, fondacioni “Soros” dhe shumë shpejt do të kemi përfaqësuesit e fondacionit “Slynn Foundation”.

Pak a shumë kështu është formatuar komisioni i ekspertëve. Natyrisht, me kompletimin e këtij komisioni dhe me ardhjen e opozitës, do të gjykojmë nëse ka nevojë për ekspertë të tjerë, për ta riformatuar dhe shtuar.

Në zbatim të vendimit nr. 4 të mbledhjes së mëparshme të këtij komisioni, u është drejtuar shkresë zyrtare Presidencës, Kuvendit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë dhe Ministrisë së Drejtësisë, për përfaqësimin e tyre në sekretariat teknik që do të funksionojë pranë këtij komisioni të posaçëm, në mbështetje të punës së ekspertëve. Në përgjigje të ftesës, kanë dërguar zyrtarisht përfaqësuesit e tyre në këtë sekretariat Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Presidenca, EURALIUS-i, OPDAT-i etj.

Në zbatim të vendimit nr. 5 të këtij komisioni, i jemi drejtuar me një shkresë zyrtare fondacionit “Soros”, ku kërkohet bashkëpunimi bazë, ndaj interesit të shprehur nga vetë drejtuesit e fondacionit, për të mbështetur veprimtarinë e komisionit, veçanërisht punën e ekspertëve dhe sekretariat teknik, nëpërmjet përgatitjes dhe nënshkrimit të një memorandum bashkëpunimi midis fondacionit dhe këtij komisioni, memorandum që është në proces diskutimi dhe negociimi.

Unë besoj që shumë shpejt mund të jetë në dispozicion të këtij komisioni.

Për të ndërtuar bazën e gjithë bashkëpunëtorëve dhe të konsulentëve pranë këtij komisioni, në funksion të nevojës që kemi për të pasur një proces gjithëpërfshirës, u jemi drejtuar një sërë institucioneve të rëndësishme, organizatave ndërkombëtare dhe ambasadave që janë në Shqipëri, për të përcjellë kontaktet e ekspertëve të angazhuar prej tyre në programe apo projekte studimore, në fakultete publike apo private të fushës së drejtësisë, për të përcjellë kontakte të pedagogëve të jashtëm dhe të brendshëm.

Ka ardhur pjesa më e madhe e përgjigjeve.

I jemi drejtuar KLD-së, për të përcjellë kontaktet për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit në territorin e vendit. Me shkresën nr. 89/1, datë 15.1.2015, KLD-ja ka informuar komisionin se KLD-ja nuk i disponon të gjitha kontaktet e trupës gjyqësore, por vetëm për kryetarë të gjykatave të rretheve gjyqësore, të gjykatave të apelit, të gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit Tiranë, si dhe të Gjykatës së Krimeve të Rënda, të Shkallës së Parë dhe të Apelit, gjë që do ta detyrojë Kuvendin t'u drejtohet të gjitha gjykatave për të pasur kontaktet e nevojshme me çdo gjyqtar të Republikës së Shqipërisë, për të qenë pjesë e këtij rrjeti dhe procesi konsultimi. Prokuroria e Përgjithshme ka përcjellë kontaktet e të gjithë prokurorëve të shkallës së parë dhe të apelit. Falënderojmë institucionin e prokurorisë për gatishmërinë, Dhomën Kombëtare, si edhe një sërë organizatash jofitimprurëse që kanë në fokus të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe sistemin e drejtësisë, të cilat i kemi ftuar të shprehin interes për të bashkëpunuar në këtë proces dhe për të caktuar personat e tyre të kontaktit. Në tërësinë e tyre ata i janë përgjigjur pozitivisht ftesës sonë dhe gjej rastin t'i falënderoj. Me këto angazhime ne sot mund të themi se kemi një rrjet kontaktesh konsultimi për gati-gati 1000 ekspertë, të cilët do të jenë në kontakt të vazhdueshëm me produktet e këtij komisioni dhe do të jenë pjesë e një procesi të gjerë konsultues në tryezat e rrumbullakëta që do të organizojmë dhe online.

Ky ishte pak a shumë një informacion. Nëse ka ndonjë pyetje nga anëtarët e komisionit, unë jam i gatshëm t'u përgjigjem.

Vazhdojmë me projektvendimet që kemi sot.

Projektvendimi i parë është miratimi i grupit të ekspertëve të nivelit të lartë pranë komisionit të posaçëm parlamentar mbi bazën e përgjigjeve që kanë dhënë institucionet e sipërcituara. Pra, natyrisht që projektvendimi është i bashkëlidhur dhe e keni mbi tryezë. Kjo nuk është një listë e mbyllur, por është e hapur dhe do ta diskutojmë kur të jenë edhe kolegët tanë të opozitës. Shpresoj që do të vijë shumë shpejt. Gjithashtu, janë edhe ekspertët e

propozuar nga organizatat dhe misionet e asistencës ndërkombëtare. Kjo është pak a shumë lista, por po i lexoj emrat për një lloj transparence:

Ardian Dvorani – Gjykata e Lartë

Ardian Nuni – Gjykata e Lartë

Sokol Sadushi – Shkolla e Magjistraturës

Mariana Semini – Shkolla e Magjistraturës

Arben Rakipi – Shkolla e Magjistraturës

Artur Selmani – Prokuroria e Përgjithshme

Enrik Ligori – Prokuroria e Përgjithshme

Maksim Haxhia – Dhoma Kombëtare e Avokatisë

Ardian Vishaj – Dhoma Kombëtare e Avokatisë

Altin Shegani – Universiteti i Tiranës

Aurela Anastasi – Universiteti i Tiranës

Artan Hoxha – Universiteti i Tiranës (E njëjta kandidaturë ka ardhur edhe nga Ministria e Arsimit, duke qenë se zoti Hoxha është anëtar i Komisionit të Reformës së Arsimit të Lartë.)

Genti Ibrahimimi – Ministria e Drejtësisë, kryetar i Komisionit të Reformës Ligjore pranë ministrit të Drejtësisë

Grupi këshillimor për reformën pranë ministrit të Drejtësisë

Ilir Panda – Ministria e Drejtësisë

Artan Hajdari – Ministria e Drejtësisë

Kristaq Traja – Fondacioni “Soros”

Dr. Rainer Deville – Misioni EURALIUS i BE-së

Jon Smibert – Misioni OPDAT i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Jay Carver – USAID, program i asistencës i Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Arthur Graham – prezenca e OSBE-së në Tiranë.

Kjo është pak a shumë lista e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë që janë atashuar deri në këto momente pranë këtij komisioni. Natyrisht që do të ketë edhe prezencën e Komisionit të Venecias. Ditën e martë do të jetë në Tiranë presidenti i Komisionit të Venecias, zoti Gianni Buchichio, me të cilin do të kemi takime të veçanta edhe në emër të këtij komisioni, edhe zoti Ministër i Drejtësisë. Besoj se pjesë e këtij diskutimi, dhe prezencës së tij, natyrisht, do të jetë edhe diskutimi për mënyrën se si do të atashohet dhe se

si do të angazhohet Komisioni i Venecias, në mbështetje të gjithë këtij procesi, pranë komisionit dhe ministrisë, gjithashtu. Kjo është pak a shumë. Biem dakord t'u japim mundësinë që të fillojnë? Dakord?

Vendimi numër 2 ka të bëjë me organigramën e sekretariatit teknik, sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe me pikë të dytë sekretariati teknik të organizohet e të funksionojë nën drejtimin e Sekretares së Përgjithshme të Kuvendit, zonjës Albana Shtylla.

Dakord? Dakord, në rregull.

E fundit, që besoj se është më e rëndësishmja, për të cilën do të dëshiroja edhe kontributin e kolegëve, është miratimi i draft-kalendarit të punës së Komisionit të Posaçëm për periudhën janar-qershor, sipas aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Me stafin e Kuvendit, së bashku me zonjën Shtylla dhe këshilltarët e Kuvendit për çështjet ligjore, kemi hartuar një draft paraprak. Gjithashtu, edhe ky, pavarësisht se ne do ta kalojmë sot në parim, ngelet i hapur, sigurisht që të përmirësohet në ditët në vijim, sepse do të jetë e domosdoshme të konsultohet edhe me vetë grupin e ekspertëve, për ngarkesën që ata do të duhet të mbajnë. Gjithsesi, në parim, nëse s'keni ndonjë gjë, e keni në tryezë.

Keni ndonjë koment për këtë? Pak a shumë me datat e me çështjet që do të mbulojnë? Është një gjë më shumë orientuese, për të pasur një dokument mbi të cilin do të ndërtohet puna. Pastaj do të jetë edhe për efekt efience të punës së komisionit, të ekspertëve e të sekretariatit teknik, por edhe për efekt transparence në raport me publikun, medien dhe partnerët.

Keni ndonjë koment për këtë gjë, për mënyrën se si mund të organizohet e të tjera e të tjera, që të jetë sa më efiçiente puna e komisionit?

Biem dakord?

**Pandeli Majko** – Zoti kryetar, unë mendoj se edhe deputetët mund të atashohen sipas zyrave që do të mbulojnë në ekspertiza, si dhe të bëhet ndarja sipas problematikave. Kështu që ne, kur të bëjmë takimet, deputetët të flasin së bashku me ekspertët, lidhur me problematikën që mbulojnë. Plus, mendoj se duhet të ketë edhe një komunikim normal edhe me opozitën, në qoftë se ata kanë ndonjë vlerësim. Nëse kanë ndërmend të vijnë, është gjëja më e mirë. Nëse nuk vijnë, punë e tyre.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

E para, nëse më lejoni t'ju jap një sqarim, unë shpresoj, në fakt jo shpresoj, por besoj se shumë shpejt opozita do të jetë këtu. S'ka asnjë arsye që të mos jetë. Përkundrazi. Hapat që janë marrë deri tani janë hapa organizativë, që i japin mundësi edhe prezencës së opozitës,

edhe fillimit të procesit, por natyrisht edhe nevojës që ne kemi për të ecur më shpejt në këtë proces, sepse ka një afat të limituar. Nuk mund të rrimë pa fund në pritje. Nga ana tjetër, për sa i përket propozimit që ka zoti Majko është propozim interesant. Dhe unë e mbështes propozimin e zotit Majko, meqenëse kjo do të varet pas diskutimit që do të bëjmë edhe me ekspertët javën që vjen, për të ecur më shpejt, për të qenë më eficientë, për ta ndarë grupin e ekspertëve sipas këtij propozimi që është bërë, në mënyrë që një grup të jetë për ndryshimet që kanë të bëjnë për ligjin për gjykatën kushtetuese, një grup të jetë për gjyqësorin, një grup tjetër për drejtësinë penale, një grup tjetër, siç është ndarë këtu te aneksi, për edukimin juridik, një grup për profesionet e lira, avokati, noteri, përmbardim dhe një grup për strategjinë antikorrupsion. Pra, me këtë logjikë edhe deputetët, një nga maxhoranca një nga opozita, të kenë mundësi të jenë për të qenë më prezent dhe më eficientë. Natyrisht pranë secilit grup duhet të ketë dhe ministria të atashuar, përveç ekspertëve të nivelit të lartë, edhe te sekretariati përfaqësuesit e vet, në mënyrë që të koordinojnë. Jam dakord me këtë propozim.

**Vasilika Hysi** - Unë ju falënderoj, zoti kryetar, për punën që keni bërë bashkë me stafin. Kam një propozim. Në kuadër të numrit të ekspertëve që janë ftuar, të atashojmë pranë edhe studentët të Shkollës së Magjistraturës, që janë aktualisht studentë, si dhe studentët e ekselencës në fakultetet e drejtësisë brenda dhe jashtë vendit. Ndoshta në pritje dhe të ardhjes së opozitës ne mund të fitojmë nga koha për t'u bërë një thirrje atyre, sepse disa mund të shprehen në portalin që do të hapet, por mund të ketë të tjerë që janë të gatshëm të atashohen pranë grupeve të punës që janë ngritur në këtë organigramë, që ne e miratuar sot. Një pjesë prej tyre kanë shprehur dhe dëshirën, kështu që do të ishte shumë i mirë t'i kemi dhe të na sjellin përvojat e ndryshme, por dhe për të bërë kërkime në kuadër të punës që mund të ketë komisioni.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** -Dakord.

Ne kemi bërë një thirrje publike për të gjithë çfarë janë ekspertë që mund të jenë angazhuar jashtë në shërbimin juridik apo në zyra, në ekipet e asistencës ligjore. Për ata që mund të jenë duke kryer studime pasuniversitare jashtë shtetit në fushën e drejtësisë, apo, gjithashtu, studentë të kësaj fushe. Besoj se kjo është një thirrje e hapur për të gjithë ata që dëshirojnë të kontribuojnë, të aplikojnë për të qenë në pjesë e këtij network-u dhe natyrisht disa që do të kenë mundësinë dhe pastaj mund të angazhohen edhe me kohë të plotë pranë sekretariatit teknik në raste që do të ketë mundësi për prezencë fizike. Është e drejtë ajo për studentët e ekselencës. Këtë nuk e kishim e menduar, por mund t'i adresohemi. Zonja Shtylla

është këtu, le t'i kërkohe ndihmë, dhe i Shkollës së Magjistraturës, pa dyshim në mënyrë më specifike.

Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** - Faleminderit!

Në parim me propozimin e zonjës Hysi jam dakord, por gjithsesi ne kemi pedagogët këtu. Kjo nuk është punë studentësh. Studentët le të vijnë, të marrin pjesë, por është një gjë me serioze sesa angazhimi i studentëve. Studentët le të vijnë të ndihmojnë, të dëgjojnë nga afër.

E dyta, nuk e di, m'u dëgjua sikur javën që vjen kemi një takim të veçantë me specialistët, me ekspertët. Dhe unë e çmoj që një takim i posaçëm i komisionit me ekspertët këtu në tavolinë që t'i shohë edhe publiku, mirë është të bëhet.

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, ta programojmë për në fillim të javës, pasdite, sepse ata janë të angazhuar.

Dakord, edhe me propozimin e zotit Braho.

Ka tjetër?

Zoti Ministër.

**Nasip Naço** - Faleminderit, zoti kryetar!

Në radhë të parë do të doja t'ju falënderoja ju dhe komisionin për këtë bashkëpunim të frytshëm deri më sot me Ministrinë e Drejtësisë.

Do të doja t'ju informoja paraprakisht që një dokument analitik është përgatitur nga Ministria e Drejtësisë dhe brenda javës do t'ju vihet në dispozicion. Ky dokument përmban një analizë të hollësishme të të gjithë sistemit të drejtësisë, përmban takimet kryesore që janë bërë në datën 6 tetor me përfaqësues të nivelit të lartë të politikës që nga Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri, kryetari i opozitës dhe ekspertëve të ardhur në datën 6 tetor në këtë konferencë, të konferencës tjetër të bërë në datën 31 tetor me ekspertë nga Ministria e Drejtësisë. Ky material i ka vajtur grupit këshillimor që është ngritur pranë ministrit të Drejtësisë me ekspertë nga më të mirët, ish-kryetarë të Gjykatës së Lartë, prokurorë të përgjithshëm, pedagogë të shkollës së Magjistraturës, një grup ekspertësh të nivelit të lartë dhe, pasi të konsultohemi me këta ekspertë, materiali do t'ju vihet në dispozicion.

Unë do të doja t'ju informoja se paralelisht këtij bashkëpunimi të ngushtë dhe koordinimit midis ekzekutivit dhe legjislativit, Ministria Drejtësisë po punon dhe shumë shpejt së bashku me misionin EURALIUS- 4 do të nxjerrim draftin kryesor, që është sistemi



i vlerësimit të gjyqtarëve. Nga prioritetet e tjera kryesore kemi vënë: kodin e procedurës penale, si edhe ligjin për administratën gjyqësore dhe strategjinë ndërsektorale për vitet 2015-2020, për reformën në drejtësi, që strategjia e Ministrisë së Drejtësisë, e cila, mendoj në të ardhmen do të inkorporohet së bashku me atë strategji që do të dalë nga ky komision nëpërmjet një vendimi të Kuvendit.

Ne po vazhdojmë dhe po bashkëpunojmë ngushtësisht me të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë, pasi e kemi thënë qartë që reformat tona do të bëhen së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë, duke vlerësuar në maksimum edhe ekspertët vendas.

Si ministër i Drejtësisë dhe përfaqësues i qeverisë shqiptare, i kam kërkuar zyrtarisht Komisionit të Venecias që të asistojë në të gjithë reformën që ne do të bëjmë në sistemin e drejtësisë, gjë për të cilën janë shprehur dakord, dhe ju e thatë që ditën e martë, përveç takimeve dhe konsultimeve që do të bëjmë, unë besoj që bashkërisht, do t'i rikërkojmë Komisionit të Venecias që të jetë pjesë e mbështetjes, konsultimeve dhe asistencës së dhënë për të gjithë këtë reformë në sistemin e drejtësisë.

Duke përfituar nga rasti do të doja që të ftoja edhe një herë opozitën dhe anëtarët e saj të zënë vend në këtë komision të posaçëm, një komision tejet i rëndësishëm për reformën në sistemin e drejtësisë.

Të gjitha palët biem dakord që sistemi ynë çalon. Të gjitha palët biem dakord që sistemi ynë nuk funksionon, dhe për sa kohë biem dakord dhe jemi bashkë në të njëjtin mendim, opozita duhet të zërë vendin e vet, të japë kontributin e vet që reforma të bëhet dhe të jetë gjithëpërfshirëse, të jetë afatgjatë dhe opozita sigurisht të japë edhe kontributin e vet.

Duke ju falënderuar edhe një herë, doja t'ju shprehja gatishmërinë e Ministrisë së Drejtësisë dhe stafit të saj që do të kontribuojë maksimalisht në këtë komision, në të gjithë reformën që do të bëhet në sistemin e drejtësisë.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Ministër!

Pa dyshim, për këtë komision dhe për vetë vendimmarrjen e Kuvendit ka qenë e qartë, është e shprehur, gjithashtu, qartazi në relacionin që ka shoqëruar vendimin për ngritjen e këtij komisioni, që Ministria e Drejtësisë është hallka kyç në këtë proces, pa bashkëpunimin e së cilës nuk është e mundur të realizohet kjo reformë e rëndësishme, kështu që nuk mund të konceptohet dhe nuk mund të mendohet ndryshe. Ne jemi këtu së bashku, dhe besoj se së bashku do të jemi edhe në vijim për shumë gjëra të tjera që kanë të bëjnë me

nevojën që kemi për të realizuar një proces sa më gjithëpërfshirës, sa më efikas dhe sa më rezultativ në funksion të përgjegjësisë që kemi marrë përsipër.,

Duke vlerësuar mbështetjen dhe konsideratën tuaj për punën e deritanishme besoj se stafi i Kuvendit, sekretarja e Përgjithshme, që do të drejtojë sekretariatit teknik së bashku me ekipin tuaj, krahas dokumentit që do të marrim, të mund të paraqesim komisionit, se cila do të jetë mënyra e realizimit të procesit të konsultimit për atë dokument, në mënyrë që të kemi mundësi të mos bëjmë mbledhje të dytë, por që në momentin që paraqitet dokumenti zonja Shtylla të paraqesë sesi do të jetë procesi i konsultimit publik për analizën e sistemit, në mënyrë që të fillojë procesi për të programuar tryezat, konsultat etj., etj. para se ky dokument final të konsiderohet i përfunduar.

Kemi gjë tjetër?

Zonja Shtylla? Dakord.

Zotërinjtë e ministrisë mbas fjalës së ministrit besoj se nuk kanë gjë, kështu që kuptohet.

Atëherë, ju të medias, besoj se po të keni ndonjë gjë më mbrapa... Faleminderit!

Edhe për ju një javë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**